



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

P.2024:077494

NE EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ Dega në Kaçanik, Gjyqtari Burim Çaka, në lëndën penale kundër të pandehurve Hamdi Vishi dhe Adem Hajdari të akuzuar secili veç e veç për veprën penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore - Ferizaj PP/II.nr.616/23 të datës 05.03.2024, lidhur me kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor, më datë 11.03.2024 merr këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET propozimi i Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.616/23 i datës 05.03.2024, gjykata lëshon këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I. Hamdi Vishi, i lindur më 10.02.1963, në fshatin Dubravë, Komuna e Kaçanikut nga babai Bafiti dhe nëna Fahrije, e gjinisë Lami, me vendbanim në fshatin Dubravë Komuna e Kaçanikut, i martuar, baba i pesë fëmijëve, ka të mbaruar shkollën e mesme, me profesion shofer, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal 1013039891, shqiptarë, shtetas i Republikës Kosovës.

II. Adem Ajdari, i lindur më 04.04.1966, nga babai Hysni dhe e ëma Hamdije, e gjinisë Salihu, me vendbanim Rr. "17 Shkurt", fshati Rekë, Komuna Kaçanik, i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, punëtor në fabrikën "Silcapor", me numër personal 1004450184, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

I

I pandehuri Hamdi Vishi

Sepse më datë 02.05.2023, rreth orës 11:00, në vendin e quajtur “Verishtë”, në fshatin Soponicë, Komuna e Kaçanikut, saktësisht në lumin Lepenc, i pandehuri me dashje bënë degradim mjedisor, ashtu që duke vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 72 paragrafi 1 pika 1.6 të Ligjit për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147, Ligjit për Miniera dhe Minerale Nr.3/L-163 si dhe Ligji Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, gjatë inspektimit nga inspektorët e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Komunës së Kaçanikut, i pandehuri është hasur duke eksploatuar rërën dhe zhavorrin, në afërsi-buzë lumit dhe sipërfaqe të afërt të rrjedhjes së lumit, me eskavatorin e tipit “Akerman”, dhe këtë veprim e ka bërë pa pasur pëlqim mjedisor dhe leje ujore, me ç’ rast ka shfrytëzuar sipërfaqen prej 827,367 metra katror dhe sasinë e mineraleve në vëllim prej 1112,267 metra kub, duke shkaktuar degradim mjedisor.

Me të cilat veprime ka kryer veprën penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 paragrafi 1 Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074.

II

I pandehuri Adem Ajdari

Me datë 02.05.2023, rreth orës 11:00, në vendin e quajtur “Verishtë”, në fshatin Soponicë, Komuna e Kaçanikut, saktësisht në lumin Lepenc, i pandehuri me dashje bënë degradim mjedisor, ashtu që duke vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 72 paragrafi 1 pika 1.6 të Ligjit për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147, Ligjit për Miniera dhe Minerale Nr.3/L-163 si dhe Ligji Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, i njëjti në pronën e tij kishte angazhuar të pandehurin Hamdi Vishin që të kryej punimet me eskavator, ku gjatë inspektimit nga inspektorët e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Komunës së Kaçanikut, i pandehuri Hamdi Vishi është hasur duke eksploatuar rërën dhe zhavorrin, në afërsi-buzë lumit dhe sipërfaqe të afërt të rrjedhjes së lumit, me eskavatorin e tipit “Akerman”, dhe këtë

veprim e ka bërë pa pasur pëlqim mjedisor dhe leje ujore, me ç'rast ka shfrytëzuar sipërfaqen prej 827,367 metra katror dhe sasinë e mineraleve në vëllim prej 1112,267 metra kub, duke shkaktuar degradim mjedisor.

Me të cilat veprime ka kryer veprën penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 paragrafi 1 Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074.

Gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 2, 17, 38, 39, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, 358, 359, 360 dhe 364 të KPPK-së, të pandehurve u shqipton.

DËNIM ME GJOBË

I. Dënim me gjobë secilit veç e veç në shumë nga 500 € (Pesëqind euro) të cilën gjobë secili veç e veç është i obliguar që ta paguaj në 2 këste mujore të barabarta në afat prej 2 muajve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do t'u zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur nga 1 ditë burgim për çdo 20 € (njëzet euro) të gjobës së pa paguar. Nëse kësti nuk paguhet me kohë, mundësia e pagesës me këste revokohet.

II. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil

III.1 Në bazë të nenit 270 paragrafi 1 Kodit Procedurës Penale, Nr. 08/L-032, konfiskohet në mënyrë të përhershme ekskavatori i tipit "AKERMAN", H10S, ngjyrë e verdhë, pronë e Isa Vishi.

III .2. Sendet e konfiskuara, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi lejohet shitja apo asgjësimi të cilin do ta bëjë Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo Konfiskuar.

IV. Detyrohen të pandehurit që në emër të shpenzimeve të procedurës si dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç ti paguaj kësaj gjykate shumën nga 20.00€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit secili veç e veç të paguaj shumën nga 20.00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj, me datë 05.03.2024, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.616/23 të datës 28.03.2023, ndaj të pandehurve Hamdi Vishi dhe Adem Hajdari të akuzuar secili veç e veç për veprën penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074, dhe i ka propozuar që pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor të lëshohet urdhëri ndëshkimor, sipas të cilit të pandehurit t'i shqiptohet dënim me gjobë.

Duke u bazuar në aktakuzën e Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.616/23 të datës 28.03.2023 dhe provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se të pandehuri në mënyrë, vend, kohë ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi dhe se në veprimet e të pandehurve arrihen të gjitha elementet e veprës penale secili veç e veç Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074.

Gjykata e shqyrtoi Aktakuzën dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor dhe gjeti se Aktakuza dhe kërkesa janë të bazuar në bazë të nenit 495 të KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-së, që të merr vendim për urdhër ndëshkimor si në dispozitiv, pasi që nga shkresat e lëndës vërtetohet se ka prova të mjaftueshme, të cilat vërtetojnë fajësinë e të pandehurit se ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë sipas Aktakuzës së Prokurorisë së Shtetit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë provat të cilat janë të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit, se ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, sipas aktakuzës së prokurorisë, kjo vërtetohet edhe nga prova si:

- Raporti i oficerit me numër të rastit: 2023-CE-131, i datës 02.05.2023;
- Raporti fillestar i incidentit me nr. të rastit:2023-CE-131, i datës 03.05.2023;
- Vërtetimi mbi sekustrimin e përkohshëm të sendeve me numër të rastit 2023-CE-131;
- Procesverbali mbi inspektimin i Inspektoratit të MMPHI me numër serik:01160 i datës 04.05.2023;
- Fletë përcjellja lajmërimi në Polici i veprës penale nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe

Minerale i datës 05.05.2023;

-Raporti i Inspektimit të jashtëligjshëm minerar i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale i datës 02.05.2023;

-Lajmërimi në Polici i veprës penale nga inspektimi i aktivitetit të jashtëligjshëm minerar;

-Urdhëresa për ndërprerjen e aktivitetit të jashtëligjshëm minerar me numër:000235, e lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) të datës 02.05.2023;

-Raport terreni për aktivitetin e jashtëligjshëm minerar me numër 000220 , e datës 02.05.2023, e lëshuar nga KPMM;

-Raporti mbi kalkulimin e vëllimit i përgatitur nga KPMM i datës 05.05.2023;

-Raporti për operim ilegal i përgatitur nga KPMM, i datës 05.05.2023;

-Shënimi zyrtar i Policisë së Kosovës i datës 02.05.2023;

-Raporti - inspektimi i MMPHI i datës 05.05.2023;

-Certifikata e paluajtshme risë P-70917083-00418-1, e lëshuar me datë 16.06.2021-pronëe të pandehurit Adem Ajdari;

-Kërkesa për sekuestrim të përkohshëm të sendeve (ekskavatorit tipit Akerman), të datës 03.05.2023;

Urdhër Përkohshëm i Ndalimit të datës 02.05.2023;

-Kërkesa për Urdhër Ndalues Përfundimtar të datës 12.05.2023;

-Urdhër Ndalues Përfundimtar të lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, Dega Kaçanik-Departamenti i Përgjithshëm, PPr. nr.2023:107707 të datës 25.05.2023;

-Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti i Përgjithshëm, PN.nr.759/23 të datës 16.11.2023;

-Fotografitë e vendit të ngjarjes dhe ekskavatorit (9) copë

-Procesverbali marrjes pyetje dëshmitares Tringa Gjickolli, në Prokurori më datë 21.07.2023;

-Procesverbali i marrjes në pyetje të pandehurit Hamdi Vishi në Stacionin Policor në Kaçanik më datë 02.05.2023 dhe në Prokurori me datë 23.06.2023 dhe;

-Procesverbali i marrjes së pyetje të pandehurit Adem Ajdari në Prokurori më datë 14.12.2023;

Të gjitha këto prova vërtetojnë veprimet në kuptim të veprës penale me të cilën akuzohen të pandehurit.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenet 69, 70 të KPRK-së ka marrë për bazë rrethanat që ndiko në llojin dhe lartësinë e dënimit për të pandehurin Hamdi Vishi në këtë aspekt si rrethana lehtësuese gjeti se nuk ka të dhëna se i pandehuri është recidivist, i ka

pranuar veprimet inkriminuese në prokurori. Ndërsa si rrethanë rënduese nuk gjeti përpos veprimeve të cilat plotësojnë figurën e veprës penale.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenet 69, 70 të KPRK-së ka marrë për bazë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit për të pandehurin Adem Ajdari në këtë aspekt si rrethana lehtësuese gjeti se nuk ka të dhëna se i pandehuri është recidivist, i ka pranuar veprimet inkriminuese në prokurori. Ndërsa si rrethanë rënduese nuk gjeti përpos veprimeve të cilat plotësojnë figurën e veprës penale.

Sipas vlerësimeve të Gjykatës dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurve, duke i marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit dhe vlerëson se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorëve të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Vendimi për konfiskimin

Gjykata lidhur me konfiskimin e sendeve për konfiskim të përherëshëm e mjetit Eskavator i tipit "AKERMAN", H10S, ngjyrë e verdhë, pronë e Isa Vishi, mbështetet në faktin se ky mjet është përdoruar nga të pandehurit për ta kryer veprën penale dhe po që se të pandehurit nuk do ta kishin pasur këtë mjet në posedim, kryerja e veprës penale pa këtë mjet do të ishte i pamundur nga ana e të pandehurve dhe si i tillë duhet të trajtohet si pasuri e specifikuar.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Gjykata konform nenit 462 paragrafi 2 të KPPK-së, palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike, e ka udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata vendimin mbi shpenzime e procedurës dhe paushallit gjyqësor e mori konform neneve 450 dhe 452 të KPPK-ës.

Gjykata vendimin mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit e mori konform nenit 36 paragrafi 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të gjitha këto arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA NË KAÇANIK

P.nr.2024:077494 datë 11.03.2024



Gjyqtari:

Ernim Caka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi - urdhëri ndëshkimor, mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit. Kundërshtimi i drejtohet Gjykatës Themelore Ferizaj dega në Kaçanik.